

URDHËR
Nr. 147, datë 9.3.2020

**PËR NDERPRERJEN E NDËRHRYJEVE KIRURGJIKALE TË PLANIFIKUARA
NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” DHE SPITALIN
UNIVERSITAR “SHEFQET NDROQI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të vendimit të datës 8.3.2020, të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, si edhe të udhëzimit nr. 395, datë 8.3.2020, të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, deri në datën 3 prill 2020.
2. Përgjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri bëjnë vetëm ndërhyrjet kirurgjikale për patologjitë malinje, të cilat do zhvillohen sipas planifikimit.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**